



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Lënda: Monitorimi i realizimit 4 Mujor të buxhetit për vitin 2025.

MINISTRISË SË FINANCAVE

Tiranë

Në zbatim të Ligjit Nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, i ndryshuar, mbështetur në udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr. 22, datë, 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, udhëzimit plotësues të ministrit të Financave Nr. 2, datë 24.1.2025 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”, po ju paraqesim raportin e monitorimit të buxhetit për periudhën janar-prill të vitit 2025.

Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për vitin 2025 i janë akorduar fondet buxhetore, sipas shtatë programeve të miratuara për sistemin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, konkretisht:

- ❖ Planifikim, Menaxhim dhe Administrimi
- ❖ Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorit
- ❖ Mbështetja për Peshkimin
- ❖ Infrastruktura e Kullimit dhe Ujitjes
- ❖ Zhvillimi Rural
- ❖ Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor
- ❖ Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës Bujqësore

Buxheti fillestar 4 mujor për vitin 2025 është 14,603,848 mijë lekë, plani përfundimtar për 4 mujorin e pare të vitit 2025 është 14,611,548 mijë lekë dhe i realizuar për periudhën paraqitet në shumën 2,417,884 mijë lekë ose 17% e planit përfundimtar.

Realizimet për shpenzime korrente janë 15%, investimet në total 19%, nga këto financimi i huaj 9%, Kosto Lokale 6%, T.V.Sh, 8 % dhe Investimet e brendshme 27%.


I detajuar realizimi për 4 mujorin e parë të vitit 2025, sipas programeve paraqitet në tabelën e mëposhtme;

Në milion/lekë

Emertimi i programit	Buxheti 2025	Struktura %	Fakti për vitin 2025		
			Fakti 2025	Realizimi %	Struktura %
Planifikim Menaxhim Administrimi	578	3.96%	136	23.53%	5.62%
Siguria Ushqimore	2,585	17.69%	671	25.96%	27.75%
Infrastruktura e Kullimit dhe Ujitjes	2,883	19.73%	900	31.22%	37.22%
Zhvillimi Rural	7,245	49.58%	378	5.22%	15.63%
Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor	759	5.19%	210	27.67%	8.68%
Menaxhimi Qëndrushëm i Tokës Bujqësore	35	0.24%	0	0.00%	0.00%
Mbështetje për peshkimin	527	3.61%	123	23.34%	5.09%
TOTALI	14,612	100%	2,418	16.55%	100%

Në realizimin për 4 mujorin e parë të vitit 2025, peshën më të madhe në nivelin e realizimit ndaj totalit, e zë programi buxhetor “Infrastruktura e Kullimit dhe Ujitjes” me 37.2% dhe pas tij programi “Siguria Ushqimore” me 27.7 % dhe “Zhvillimi Rural” me 15.6%.

Struktura e shpenzimeve të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për çdo program, sipas planit të buxhetit të vitit 2025 dhe realizimit faktik për 4 mujorin e parë, paraqitet:



Monitorimi i shpenzimeve, sipas programeve

1- Programi 04250, “Zhvillimi Rural”

Realizimi i shpenzimeve për 4 mujorin e parë të vitit 2025 të programit “Zhvillimi Rural në mbështetje të bujqësisë, blegtorisë, agroindustrisë dhe marketingut”, që përfaqëson **49.58%** të totalit të buxhetit fakt të kësaj ministrie, sipas zërave kryesorë, krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

- | | |
|-----------------------|-------------|
| • Shpenzimet korrente | 4% |
| • Shpenzimet kapitale | 9.1% |
| Gjithsej | 5.2% |

Programi buxhetor “Zhvillimi Rural në mbështetje të Bujqësisë Blegtorisë, Agroindustrisë dhe Marketingut”, për vitin 2025, ka në dispozicion gjithsej **7,244,780,000 lekë**, nga të cilat:

- Shpenzime korrente 5,032,009,000 lekë, dhe
- Shpenzime kapitale 2,212,771,000 lekë

Nga ana e institucioneve, pjesë e programit, për 4 mujorin e parë të vitit janë marrë të gjitha masat për të realizuar aktivitetet e planifikuara në kohë dhe me cilësi, ndër të cilat rendisim:

- Miratimi i bazës ligjore për masat mbështetëse, të Programit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për vitin 2025. Miratuar VKM nr.150 datë 6.3.2025, Udhëzimi i përbashkët nr. 14 datë 28.3.2025, si dhe ndryshimi udhëzimit nr. 16 datë 17.4.2025;
- Vijon aplikimi në skemat kombëtare, në skemën e mbështetjes me naftë për punimet e mekanizuara në bujqësi;
- Lidhur 251 kontrata në kuadër të skemës së investimeve;
- Degustimi i rreth 31 mostrave të duhanit dhe 76 puro;

- Promovuar bizneset dhe produktet shqiptare në 4 aktivitete ndërkombëtare dhe 2 kombëtare;
- Kryer vrojtimi statistikor, si dhe agroindustrinë;
- Vlerësuar dhe dhënë mendimi pozitiv për aplikim për regjistrim nën skemat e cilësisë me emërtimin TGJM (Tregues Gjeografik i Mbrojtur), për “Mjalti bedunicës Frashër”, Përmet, Gjirokastrë;
- Në fazë implementimi aktivitetet nga Projektet e Huaja, etj.

Nisur nga realizimi faktik rezulton se janë shpenzuar rreth 4.5% e fondit total vjetor të planifikuar të rishikuar. Kjo për arsye se nuk ka filluar disbursimi i fondeve të skemave kombëtare, investimet janë në procedura prokurimi, projektet e huaja nuk kanë filluar ende nga disbursimi, si dhe një pjesë e pagesave kryhet në 4 mujorin e fundit të vitit. Fondet e planifikuara për paga si dhe shpenzime korrente (detyrime: energji, ujë, telefoni, mirëmbajtje, karburant, transport, etj), janë realizuar nga të gjitha institucionet e varësisë. Përsa i përket indikatorit “Numër përfituesish burra dhe gra nga skemat kombëtare”, duke qenë se jemi ende në fazën e aplikimeve, nuk mund të specifikohet ky tregues.

Lidhur me këtë aspekt, gjatë kësaj periudhe në bashkëpunim me koordinatorin gender në ministri, janë organizuar disa takime me ekspertët e QTTB-së Fushë Krujë, për hartimin e planit të punës dhe fillimin e procedurave të monitorimit.

Ecuria e disa produkteve kryesore:

Masat mbështetëse. Gjatë kësaj periudhe është hartuar baza ligjore VKM, udhëzim i përbashkët, si dhe ndryshimi i udhëzimit, si dhe është hapur dhe do të vazhdojë deri në datë 30 maj 2025 procesi i aplikimit.

Skema e subvencionimit me naftë për mekanizimin në bujqësi.

Në proces aplikimi për këtë skemë.

Skema e investime me grant në ferma.

Janë gjithsej 251 kontrata të lidhura për Skemën e Investimeve Kombëtare, nga të cilat gjithsej janë 38 gra dhe 213 burra. Për periudhën raportuese janë disbursuar 5,540,868 lekë për 7 përfitues, nga të cilët 1 përfitues është grua.

Aktivitete promovuese.

Gjatë kësaj periudhe është mundësuar pjesëmarrja në 5 aktivitete promovuese ndërkombëtare “AGRITECH 2025”, në Katar; “Puno dhe jeto aty ku ke zemrën”, në Greqi; “The World’s Leading Travel Trade Show”, në Gjermani; “VinItaly” dhe “Macfruit 2025”, në Itali, si dhe panairi kombëtar “Ditët e Bujqësisë 2025”, në Lushnjë. Përfaqësimi në këto aktivitete ka qënë shumë i kënaqshëm duke mundësuar njohjen e Shqipërisë dhe produkteve shqiptare, si dhe duke krijuar një qëndrueshmëri dhe stabilitet të subjekteve pjesëmarrësve, për të mundësuar në fund krijim kontaktesh dhe lidhje kontratash. Në këto aktivitete morën pjesë rreth 49 subjekte/përfaqësues nga të cilët 8 gra.

Mostra të degustuara të duhanit për ruajtjen e shëndetit të konsumatorëve.

Nga ana e AKDC-së, gjatë kësaj periudhe janë degustuar 20 mostra dhe analizuar 44 puro/duhan i grirë dhe cigare të gjeneratës së re. Po ashtu nga ana e AKDC-së janë trajnuar fermerët kultivues të duhanit lidhur me metodat dhe teknologjitë më të fundit.

Vrojtime statistikore.

Gjatë kësaj periudhe nga Sektori i Statistikave, është realizuar vrojtimi vjetor bujqësor për vitin 2024, si dhe vrojtimi agroindustrisë. Këto vrojtime kryhen në bashkëpunim me INSTAT, sipas metodologjisë së përcaktuar prej tyre.

Njësi vreshti dhe ullishte të rregjistruara.

Për programin “Krijimi i Kadastrës së Ullirit”, është përgatitur dhe miratuar programi me objektivat, rezultatet e pritshme, shpenzimet e planifikuara, si dhe grafiku i aktiviteteve për realizimin e objektivave të planifikuara. Po ashtu është siguruar informacioni paraprak për zonat e kultivuara me ullishte në njësitë administrative të bashkisë Fier, Mallakastër, Patos, Lushnjë të qarkut Fier, si dhe në bashkinë Çorovodë të qarkut Berat, për rreth 13,000 njësi ullishte që pritet të rregjistrohen. Për programin “Përditësimi i Kadastrës së vreshtit”, është përgatitur dhe miratuar programi me objektivat, rezultatet e pritshme, shpenzimet e planifikuara, si dhe grafiku i aktiviteteve për realizimin e objektivave të planifikuara. Është siguruar informacioni paraprak për zonat e kultivuara me vreshta të reja, vreshta të shkulura, si dhe parcela me vreshtae mbi 500m² në bashkinë: Kuçovë dhe Çorovodë. Po ashtu është realizuar trajnimi me 60 specialistë në Sektorët e Ekstensionit Bujqësor në qarkun Berat, Kukës, Durrës dhe Fier me objekt “Informimi me Ligjin Nr. 86/22 Për “Vreshtarinë dhe verën”, si dhe aktet nënligjore, për detyrimet dhe përgjegjësitë që kanë SEB-et në zbatimin e këtij ligji.

Shqyrtimi dhe vlerësimi i aplikimeve për EOM, TGJM dhe STG.

Gjatë kësaj periudhe nga struktura përgjegjëse në Ministri për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore, janë realizuar dy takime për vlerësimin e aplikimit për rregjistrim me TGJM (Tregues Gjeografik i Mbrojtur), “Mjalti i bedunicës Frashër”, Përmet, Gjirokastrë. Po ashtu janë dhënë dhe “Certifikatat e Cilësisë”, për dy produkte të rregjistruara si TGJM: “Molla e Dvoranit”, Korçë dhe “Vaj ulliri Valmi, Elbasan”.

Projekte investimesh të brendshme.

Projektet e investimeve janë çelur dhe akoma nuk kanë filluar procedurat e tenderimit.

- Për QTTB Fushë Krujë, edhe pas disa kërkesave të dërguara tek AKSHI për “Përmirësimin e sistemit të kadastrës së vreshtit”, akoma nuk ka përgjigje.
- Lidhur me studimin “Për përcaktimin e zonave të kultivimit të vreshtit për verë”, janë kryer procedurat e prokurimit, është lidhur kontrata dhe ka filluar puna.

2. Programi 04220, “Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorit”

Realizimi i shpenzimeve për 4 mujorin e parë të vitit 2025 në këtë program, që përfaqëson 17.69% të totalit të buxhetit fakt të kësaj ministrie, sipas zërave kryesorë, krahasuar me planin vjetor të rishikuar, rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet 29%
- Investimet 7%
- Gjithsej 25.9%**

Politika në fushën e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit synon përmirësimin e kuadrit ligjor duke e përshtatur atë me legjislacionin e BE-së, hartimin dhe zbatimin e programeve kombëtare të kontrollit të sëmundjeve në kafshë e dëmtuesve në bimë, programeve të monitorimit të sëmundjeve, mbetjeve në kafshë dhe në produktet ushqimore me origjinë shtazore, monitorimit të ujërave e molusqeve bivale, identifikimin e kafshëve dhe regjistrimin e fermave blegtorale, forcimin e karantinës veterinarë e fitosanitare, përdorimin e praktikave të mira në mbrojtjen e shëndetit të bimëve, fuqizimin e rrjetit laboratorik, fuqizimin e inspektimeve mbi sigurinë ushqimore, vendosjen e sistemit të vetëkontrollit dhe informimin në kohë të konsumatorit.

Për vitin 2025 janë në proces aktivitetet mbi masat profilaktike veterinarë fitosanitare, programi i monitorimit të mbetjeve në kafshët e gjalla dhe produktet me origjinë prej tyre, monitorimi i ujërave e molusqeve bivalve, monitorimi i dëmtuesve në bimë dhe produkte bimë, identifikimi i kafshëve dhe hedhja e të dhënave në sistemin e informacionit blegtoral dhe veterinar Ruda, luftimi i dëmtuesve në bujqësi dhe mbështetja e të gjithë aktiviteteve të Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes të Bimëve (AKVMB), Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV) dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU) me 12 Drejtoritë Rajonale të AKU si dhe analizimi, testimi dhe certifikimi i farave dhe fidanëve të certifikuar nga Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve.

Produktet e përfituara, janë realizuar si më poshtë:

- **90502AA “Kafshë të vaksinuara dhe të gjurmuara”:**

Vaksinimi është një proces në zbatim të strategjive të miratuar dhe kryhet me vaksinë të blerë që mbulohet nga buxheti i Ministrisë të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR). Deri në fund të muajit prill janë vaksinuar:

- 2,221 krerë kafshë kundër sëmundjes të plasjes;
- 84,049 krerë kafshë të imta kundër sëmundjes së Brucelozës;
- 26,103 krerë janë gjurmuar për tuberkulozin.

Në këtë zë janë përfshirë edhe shpenzimet veterinarë të katër Drejtorive Rajonale të AKVMB-së (*blerja e bazës materiale, certifikatat që lëshohen në thertore, baza materiale për sistemin RUDA, blerja e dezinfektantëve, dërgimi i mostrave në ISUV,*

dhe dëmshpërblimi). Fondi i planifikuar (në total për 4 DRVMB-të) për shpenzimet veterinarë është në vlerën 35,000,000 lekë. Janë realizuar shpenzime në vlerën **9,985,000 lekë (29%)**. Ky shpenzim i përket dëmshpërblimeve dhe për periudhën Janar-Prill 2025 janë dëmshpërblyer fermerët për 14 kafshë të ngrodhura/të eliminuara, nga të cilët 5 krerë gjedhë janë eliminuar për shkak të sëmundjes së tuberkulozit dhe 9 krerë gjedhë për shkak të sëmundjes së brucelozës.

- **90502AB “Kafshë të shëndetshme dhe të kontrolluara”:**

Janë realizuar kontrole në fermat e kafshëve të gjalla, në farmacitë veterinarë, depot farmaceutike, kontrolli i bimëve dhe produkteve bimësi dhe monitorime fitosanitare rreth **8,118 kontrole** deri në fund të muajit prill. Është realizuar gjurmimi i sëmundjes të Brucelozës në **12,218 krerë gjedhë** dhe gjurmimi i sëmundjes së TBC në **26,103 krerë gjedhë**. Janë realizuar shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore (llogaria ekonomike 600+601) në vlerën **280,564,404 (34%)** lekë, shpenzimet për mallra dhe shërbime (llogaria ekonomike 602) në vlerën **3,797,807 (10%)** lekë dhe transfertat për familjet dhe individët (llogaria ekonomike 606) në vlerën **786,440 (96%)** lekë.

- **90502AC “Matrikuj të blerë për kafshët”:**

Është përgatitur procesverbali i specifikimeve teknike dhe jemi në pritje të udhëzimeve të mëtejshme nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural rreth prokurimit të kësaj procedure në sistem.

- **90502AD “Analiza të kryera në kuadër të monitorimit të mbetjeve në kafshët e gjalla dhe molusqet bivale”:**

Janë realizuar kane testuar **6,623 kampione** dhe kane kryer **59,534 analiza** nga ISUV ku përfshihen dhe **519 analiza** të kryera jashtë vendit, në laboratorë të nënkontraktuar. Kampionet janë dërguar nga veterinerët zyrtar, inspektorët e AKU-së dhe operatorët e biznesit të cilët eksportojnë drejt vendeve të Open Ballkan dhe më gjerë. Janë realizuar dhe shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore (600+601) në vlerën **54,548 mijë lekë 36%** e total fondit për vitin 2025, shpenzimet për mallra dhe shërbime (602) **24,228 mijë lekë 12%** e total fondit për vitin 2025, investimet e brendshme dhe transfertat për familjet dhe individët (606) për katër mujorin e parë nuk ka asnjë likuidim.

- **90502AE “Emergjenca veterinarë dhe emergjenca për sigurinë ushqimore”:**

Janë hedhur procedurat e tenderimit në sistem nga Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, si më poshtë:

1. Procedura e tenderimit të blerjes së alergenëve tuberkulinë bovine dhe aviare në vlerë 21,700,000 (njëzet e një milion e shtatëqind mijë) lekë pa TVSH,
2. Procedura e tenderimit të blerjes së vaksinës kundër sëmundjes së plasjes në vlerë 11,500,000 (njëmbëdhjetë milion e pesëqind mijë) leke pa TVSH.

- **90502AF** “*Fara dhe fidanë të analizuara, testuar dhe certifikuar*”:

Për periudhën Janar-Prill 2025 janë kryer **136 analiza** të cilat kanë qenë për të përcaktuar fuqinë mbirëse, testin e pastërtisë, testin e lagështirës, në analiza për efekt vetkontrolli, analiza zyrtare të sjella nga AKU, analiza për certifikim të mmbsh si dhe analiza të sjellë nga Shoqata Ndërkombëtare e Testimit të Farave si teste aftësie. Janë certifikuar në total **15.159.925** fidanë frutorë, fidanë perimorë dhe fidanë dekorativë si dhe janë testuar **43 varietete** të reja për vlerën e kultivimit dhe të përdorimit për tu regjistruar në Katalogun Kombëtar.

- **90502AG** “*Inspektimi dhe menaxhimi i riskut në fushën e sigurisë ushqimore*”:

Drejtoritë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (DRAKU) kanë realizuar në të gjithë territorin e vendit deri në fund të muajit prill, **36,991 inspektime**. Sektorët e shërbimeve laboratorike të AKU kanë pranuar në total **2,383 kampione** të cilat janë analizuar për **4,704 tregues analitik**. Janë realizuar dhe shpenzimet paga + sigurime (600+601) në masën 36% dhe 37%, shpenzime korrente (602) në masën 21% me vlerë **36,627,603 lekë**, specifikimet teknike për zërin investime të brendshme dhe **606 në masën 19% dhe vlerë 223,450 lekë**.

- **90502AH** “*Kontrolli dhe mbrojtja nga dëmtuesit në fushën e bujqësisë*”:

Ky fond nuk është përdorur pasi nuk ka pasur sinjalizime për shfaqjen e ndonjë dëmtuesi në bujqësi për 4-mujorin e parë të vitit 2025.

- **90502AI** “*Funksionimi i Autoritetit Kombëtar Veterinar dhe Mbrojtjes të Bimëve*”:

AKVMB ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e vendit dhe ka fushë përgjegjësie shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve dhe shëndetin e bimëve. Realizimi (Janar – Prill 2025) është në vlerën **8,144,576 lekë (41%)**. Drejtoria e Përgjithshme e AKVMB-së, për periudhën janar – prill 2025, ka kryer **127 inspektime dhe monitorime** në terren nga Drejtoria e Mbrojtjes së Bimëve dhe Drejtoria e Veterinarisë.

Investimet e Brendshme:

- Investimi për kod projektin **24AD701** “*Fuqizimi i kapaciteteve laboratorike të ISUV në të tre fushat ku ushtron aktivitetin e tij analitik, siguri ushqimore, shëndet kafshësh dhe bimësh*”, janë blerë 18 pajisje laboratorike, nga projekt investim që ka filluar nga viti 2024. Ky investim është drejt finalizimit të tij ku me instalimin e pajisjeve janë bërë edhe validime metodash. Pritet të realizohet 100% deri në fillim të muajit Qershor 2025.
- Investimi për kod projektin **24AD601** “*Përmirësimi dhe zgjerimi i infrastrukturës laboratorike, dhe shtrimin e linjave të gazit për Departamentin e Mbrojtjes dhe Shëndetit të Bimëve*” është një investim në ecuri, është aplikuar për marrjen e lejes së ndërtimit për fillimin e zbatimit të kontratës së lidhur me Operatorin Ekonomik.

- Investimi me kod projekti **18AJ104** “*Rikonstrukcion i zyrave të DRVMB Vlorë*”, është projekt në vazhdim nga viti 2024, për katër mujorin e parë të vitit 2024, është realizuar 80% e fondit të akorduar, deri në fund të vitit 2025, pritet realizimi 100% i punimeve dhe i fondit të akorduar.
- Lidhur me Projektin me kod **M050163** “*Kosto Lokale (Bashkëfinancim për marrëveshje me FAO)*”, është realizuar pagesa bazuar marrëveshjes me FAO për projektin “*Përmirësimi i prodhimit të qëdrueshëm të Gështenjës në Shqipëri përmes kontrollit biologjik të insekteve dëmtuese*” dhe diferenca e mbetur është diferenca nga kursi i këmbimit.

Lidhur me Projektet me Financim të huaj:

- Projekti me kod **19AB704** “*SMALL SCALE PROJECT - SA-0100050 – EFFORG / Interreg IPA*”, gjatë katërmujorit të parë të vitit 2025, ka patur dy takime dhe një kërkesë zyrtare për shtyrje/zgjatje afati. Akoma nuk ka filluar.
- Projekti me kod **19AB705** “*Përmirësimi i përgjithshëm i standarteve të sigurisë ushqimore përgjatë zinxhirit shqiptar të produkteve tipike vendase - GRANT*”, gjatë katërmujorit të parë të vitit 2025, është bërë zgjedhja e makinerive dhe agregateve bujqësore bazuar specifikimeve teknike të cilat do të blihen nga donatori (*Mediterranean Agronomic Institute of Bari*), janë bërë takimi për koordinimin dhe përcaktimin e aktiviteteve për periudhën 2025-2026 të Qendrave të Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë Krujë dhe Shkodër, si dhe SHBB “*HARVEST HUB – Albania*” për rivitalizimin e misrit autokton “*Sulova*”.
- Projekti me kod **19AB706** “*Ndërtimi i kapaciteteve në fushën e Arsimimit dhe Trajnimit Profesional (CultiVETing)*” të mbështetur nga ERASMUS-EDU-2023-CB-VET”, është ende në fazat e para të implementimit dhe nuk ka pasur aktivitete.

3. Programi 04240, “Menaxhimi i Infrastrukturës së Kullimit dhe Ujitjes”

Realizimi i shpenzimeve për 4 mujorin e parë të vitit 2025, për këtë program, që përfaqëson **19,73%** të totalit të buxhetit fakt të kësaj ministrie, sipas zërave kryesorë, krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

- | | |
|-----------------------|--------------|
| • Shpenzimet korrente | 28% |
| • Shpenzimet kapitale | 33% |
| Gjithsej | 31.2% |

Në këtë 4 mujor nëpërmjet këtij programi, rezulton:

Me shpenzimet operative, vazhdojnë punimet, fokusuar kryesisht për mirëmbajtjen e objekteve të infrastrukturës së ujitjes, për pasjen në funksion të kanaleve kryesor ujitës për sezonin ujitës të këtij viti (veçanarisht kanalet kryesor ujitës Peqin-Kavajë, që mbulon me ujitje bashkitë Peqin, Rrogozhin dhe Kavajë, kanalet Naun Panxhi dhe Poilis Tudan, që mbulojnë me ujitje bashkinë Elbasan, si dhe veprat e marrjes së ujit për disa kanale kryesor ujitës në administrim të MBZHR si kanalet Mat-Lezhë, Mat-Kurbin në Lezhë e Kurbin, Vjose-Levan-Fier, në Fier, Degët Ujitëse me rezervuarin e Thanës në Lushnjë etj).

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe ka filluar puna edhe për pastrimin e kanaleve kryesor kullues dhe mbajtjen në funksion të plotë të 27 hidrovoreve, që kullojnë rreth 70,000 ha në ultësirën perendimore.

Në lidhje me projektet me investimet të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, veprave të mbrojtjes nga përmbytja dhe hidrovoret, të financuara me buxhetin e vitit 2025, sqarojmë se:

- Në total janë 80 projekte, nga të cilët:
- Në vazhdim nga viti 2024 70 projekte
- Të reja 10 projekte

Për 10 objektet e rinj, është bërë çelja e financimit për 8 objekte, që i përkasin DUK-ve ndërsa për 2 objektet e bashkive (hidrovori i qytetit të Vlorës me vlerë të plotë 169 milion lekë dhe kanalet sekondare në bashkinë Vau i Dejës, me vlerë 30 milion lekë), nuk janë çelur financimet, pasi nuk është mundur deri tani të miratohet projektvendimi përkatës.

4. Programi 04860, “Këshillimi dhe Informacioni bujqësor”.

Realizimi i shpenzimeve për 4 mujorin e parë të vitit 2025, për këtë program që përfaqëson rreth **5.19%** të totalit të buxhetit fakt të kësaj ministrie, sipas zërave kryesorë, krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

• Shpenzimet korente	30%
• Shpenzimet kapitale	0 %
Gjithsej	27.7%

Në programin “Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor”, përfshihet financimi i aktivitetit të Qendrave të Transferimit të Teknologjive Bujqësore dhe Agjencive Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, të cilat ndiqen nga sektorët përkatës.

Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB).

Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB), gjatë 4 mujorit të vitit 2025 e kanë përqëndruar aktivitetin e tyre në realizimin e detyrave të planifikuara sipas programit të punës të miratuar, për këtë vit.

Produktet e parashikuara të këtij programi janë realizuar si vijon:

Produkti 90506AA: “Paketa dhe karta teknologjike të prodhuara nga 5 QTTB-të, që ju vihen në dispozicion fermerëve dhe agrobizneseve dhe aplikohen prej tyre”. Shpenzimet e planifikuara për këtë produkt, në përfundim të 4 muorit të vitit 2025, janë realizuar në masën 25% krahasuar me planin vjetor të rishikuar të shpenzimeve. Për vitin 2025, janë planifikuar për tu realizuar 16 teknologji/paketa teknologjike (elementë të përmirësuar). Aktivitetet që i shërbejnë **Produktit 90506AA** janë studime, teknika dhe teknologji në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë, testime, mirëmbajtje dhe rigjenerime të koleksioneve gjenetike, që përdoren për përmirësimin e komponentëve prindëror të farërave dhe fidanëve si dhe prodhimin e hallkave të larta që u ofrohen fermerëve me çmime konkurruese.

Produkti 90506AB: “Qendra të Transferimit të Teknologjive Bujqësore funksionale”: Shpenzimet për këtë produkt, gjatë 4 muorit të vitit 2025 janë realizuar në masën 22 %. Shpenzimet për këtë produkt i dedikohen përmbushjes së detyrave funksionale të QTTB-ve dhe janë shpenzime që realizohen të ndara në financimin e Projekteve dhe Financimin Institucional.

Produkti 90506AC: “Gra të informuara dhe trajnuara nga shërbimi këshillimor publik”. Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore në bashkëpunim me Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, për vitin 2025 kanë planifikuar për të realizuar 5 ditë trajnimi të dedikuara për 520 gra fermere, me synim zbutjen e parabarazisë dhe integrimin gjinor. Këto trajnime do të realizohen kryesisht gjatë 6 muorit të II-të të vitit.

Produkti 90506AD: “Fermerë të asistuar nga Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor për aplikimet në skemat kombëtare dhe IPARD”. Përgjatë fushatës promovuese deri me tani, janë asistuar rreth fermerë 55,515 aplikantë nga 70,000 të planifikuar.

Produkti 90506AE: “Fermerë të kontaktuar dhe ofruar shërbime ekstensionit”. Aktivitetet që shërbejnë për realizimin e këtij produkti janë: 27 kërkime në nivel ferme që realizohen nga QTTB-të në bashkëpunim me strukturat e Shërbimit të Ekstensionit, në ferma të ndryshme në të gjithë territorin e vendit; trajnime nga QTTB-të, Universiteti Bujqësor dhe Projekte që veprojnë në fushën e bujqësisë në mbështetje të zhvillimit të kapaciteteve për specialistët e Ekstensionit dhe këta të fundit në përmirësimin dhe freskimin e njohurive të fermerëve të interesuar.

Produkti 18AL404 “Pajisje kompjuterike të blera AREB Korçë”, 1,000 mijë lekë. AREB Korçë është në fazën e përgatitjes së specifikimeve teknike për produktet që do të blihen. Procedura do të hidhet në sistem në fillim të muajit qershor. Blerja do të realizohet në muajin Korrik, muaj në të cilin është miratuar limiti i arkës (Kesh-i mujor).

Produkti 18AL405 “Pajisje kompjuterike të blera AREB Shkodër”, 1,000 mijë lekë. Janë përgatitur specifikimet teknike. Është dërguar kërkesa në AKSH. Procedura do të realizohet në muajin Korrik, muaj në të cilin është miratuar limiti i arkës (Kesh-i mujor).

Produkti 18AL406 “Pajisje kompjuterike të blera AREB Lushnje”, 600 mijë lekë.
Janë përgatitur specifikimet teknike; Pritet hedhja në sistem. Procedura do të realizohet në muajin Qershor, muaj në të cilin është miratuar limiti i arkës (Kesh-i mujor).

Produkti 18AL411 “Pajisje kompjuterike të blera nga QTTB Fushë Krujë”, 1,200 mijë lekë. Janë përgatitur specifikimet teknike dhe është dërguar kërkesa në AKSH.

Produkti 18AL525 “Baza eksperimentale e QTTB Vlorë e rrethuar”, 5,500 mijë lekë.
Procedura e tenderimit është planifikuar për t’u zhvilluar më 25.06.2025, sipas parashikimit në rregjistrin e prokurimeve publike.

Produkti 18AL526 “Hapje pusesh nga QTTB Korçë”, 2,700 mijë lekë.
Janë përgatitur specifikimet teknike. Është dërguar kërkesa në OBP. Objekti planifikuar për tu tenderuar në muajin Maj, sipas parashikimit në rregjistrin e prokurimeve publike.

Produkti 18AL622 “Agregatë bujqësorë të blera nga QTTB Lushnje”, 3,900 mijë lekë.
Janë bërë specifikimet teknike dhe është dërguar kërkesa tek OBP. Objekti planifikuar është për t’u tenderuar në muajin Maj, sipas parashikimit në rregjistrin e prokurimeve publike.

Produkti 18AL623 “Pajisje sistemi ujitës të blera nga QTTB Shkodër”, 2,000 mijë lekë, është në proces përgatitja e specifikimeve teknike. Objekti i planifikuar për tu tenderuar në muajin gusht, sipas parashikimit në rregjistrin e prokurimeve publike.

Produkti 18AL624 “Pajisje zyrash të blera nga AREB Korçë”, 400 mijë lekë.
AREB Korçë është në fazën e përgatitjes së specifikimeve teknike për produktet që do të blihen. Procedura do të hidhet në sistem në fund të muajit maj ose në fillim të muajit qershor.

Produkti 18AL625 “Pajisje zyrash të blera nga QTTB Fushë Krujë”, 400 mijë lekë.
Janë përgatitur specifikimet teknike dhe është në proces prokurimi.

Produkti M050392 “Pajisje zyrash të blera nga AREB Lushnje”, 300 mijë lekë.
Janë përgatitur specifikimet teknike; Pritet hedhja në sistem. Procedura do të realizohet në muajin Qershor.

Produkti M050778 “Blerje pajisje kompjuterike nga AREB Tiranë”, 1,000 mijë lekë.
Janë përgatitur specifikimet teknike. Është dërguar kërkesa tek AKSHI. Blerja do të realizohet në muajin Korrik.

Produkti M050437 “Fond i ngrirë”, 30,000 mijë lekë.
Fondi është i ngrirë për periudhën e raportimit. Gjatë periudhës në vijim është i destinuar për 3 objekte investimesh:

- “Blerje pajisjesh laboratorike nga QTTB Fushë Krujë”;
- “Rikonstruktion çatie nga QTTB Fushë Krujë”;
- “Rikonstruktion laborator (faza e I-rë) nga QTTB Korçë”.

Shërbimi i Ekstensionit

Gjatë 4 mujorit të vitit 2025, nga strukturat e Shërbimit Këshillimor u kontaktuan direkt dhe indirekt dhe morën informacion gjithsej rreth 41,667 fermerë dhe agrobiznese (nga të cilët 2,693 janë gra fermere) nga 100,000 fermerë dhe agrobiznese të synuara.

Gjatë 4 mujor të vitit 2025, u realizuan 57 ditë trajnime të hapura me specialistë të bujqësisë ose 1,126 ditë/ekstensionistë të trajnuar nga 150 ditë trajnimi të planifikuara deri në fund të vitit 2025, si dhe 556 ditë trajnime me fermerë, me pjesëmarrjen e 4,364 fermerëve të interesuar, kryesisht për çështje teknike, ekonomike, të kooperimit, marketingut, për ndryshimet klimatike etj.

Janë realizuar 577 demostrime me pjesëmarrjen e rreth 4,062 fermerëve, 40 ditë fushe me pjesëmarrjen e 269 fermerëve, janë shpërndarë për të interesuarit 16,790 copë fletëpalosje për probleme të ndryshme të teknologjisë në bimë e kafshë, kooperimit bujqësor, menaxhimit të integruar të fermës, marketingut, etj. Janë realizuar 34 kronika dhe emisione televizive në TV lokale.

5. Programi 01110, “Planifikim, Menaxhim, Administrimi”

Realizimi i shpenzimeve për 4 mujorin e parë të vitit 2025, për këtë program, që përfaqëson 3.96% të realizimit të kësaj ministrie, sipas zërave kryesorë, krahasuar me planin vjetor, rezulton si më poshtë:

- | | |
|-----------------------|------|
| • Shpenzimet korrente | 26 % |
| • Shpenzimet kapitale | 0 % |

Gjithsej	23.5%
-----------------	--------------

Në programin buxhetor “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi”, përfshihet financimi për pagat e punonjësve të aparatit të MBZHR-së, për trajnimet e nëpunësve, për përmirësimin e strukturës funksionale të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, kapaciteteve menaxhuese dhe implementuese në institucion, në funksion të hartimit dhe monitorimit të politikave.

Produktet e parashikuara të këtij programi buxhetor janë realizuar si vijon:

Produkti: 90501AA Akte ligjore dhe nënligjore të miratuara (Puna e stafit të ministrisë për hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore)

Ky produkt sipas planit të rishikuar në vlerën 352,536,000 lekë, për periudhën janar-prill 2025 është realizuar në vlerën 110,726,619 lekë.

Produkti: 90501AB Institucion në mirëfunksion (Kapacitetete menaxhuese dhe implementuese në institucion dhe mirëfunksionale për hartimin dhe monitorimin e politikave).

Ky produkt sipas planit të rishikuar në vlerën 111,980,000 lekë, për periudhën janar-prill 2025 është realizuar në vlerën 20,150,119 lekë.

Produkti: 90501AC Personel i trajnuar (Aftësi në rritje të stafit përmes trajnimeve të ndryshme të nevojshme për realizimin e detyrave funksionale).

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore të afta për implementimin e politikave ekzistuese, si dhe të mirëtrajnuara për t'ju përshtatur proceseve integruese ishin planifikuar për t'u realizuar 163 trajnime në drejtim të arritjes së standarteve të sigurisë ushqimore, zhvillimit rural, ujitjes dhe kullimit etj. Gjatë periudhës janar-prill 2025 janë realizuar 56 trajnime nga stafi i institucionit.

Ky produkt sipas planit të rishikuar në vlerën 15,000,000 lekë, për periudhën janar-prill 2025 është realizuar në vlerën 4,388,280 lekë. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe personeli i MBZHR-së ka ndjekur trajnimet pranë ASPA-s apo institucioneve të tjera, të cilat nuk janë me pagesë.

Produkti: 90501AD Pagesë për kuotat ndërkombëtare të realizuara

(Për ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore të institucionit nevojitet pjesëmarrja në takime vjetore ndërkombëtare, trajnime, Workshope, të cilat kërkojnë shpenzime për kuota anëtarësimi në organizma ndërkombëtare).

Republika e Shqipërisë aderon në disa organizata ndërkombëtare me të cilat ka lidhur edhe marrëveshje. Në kuadër të këtyre marrëveshjeve MBZHR ka detyrime për përmbushjen e 15 kuotave financiare për pjesëmarrjet ku ajo aderon.

Ky produkt sipas planit të rishikuar në vlerën 40,000,000 lekë, për periudhën janar-prill 2025 nuk është realizuar, pasi nga organizatat ndërkombëtare faturat u paraqitën me vonë.

Produkti: Kodi 90501AE Institucione të audituara (Auditimi i institucioneve të varësisë së MBZHR-së).

Referuar planit të auditimeve, për vitin 2025 janë planifikuar për auditim 16 institucione. Për periudhën janar-prill 2025 ky produkt sipas planit të rishikuar në vlerën 3,000,000 lekë, për periudhën janar-prill 2025 është realizuar në vlerën 1,078,000 lekë.

Produkti: Rikonstruksioni i ambienteve në MBZHR

Fondi i ngrirë në vlerën 55,000,000 lekë vazhdon të jetë i ngrirë, pasi procedura e rishikimit të projektit për rikonstruksionin e ambienteve të MBZHR-së nuk ka përfunduar.

6. Programi 04230, “Menaxhimi i Peshkimit”

Realizimi i shpenzimeve për 4 mujorin e parë të vitit 2025 për këtë program, që përfaqëson 3.61% të buxhetit faktik të kësaj ministrie, sipas zërave kryesorë, krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

• Shpenzimet korrente	23%
• Shpenzimet kapitale	24 %
• Gjithsej	23.3%

Politikat në fushën e peshkimit janë në përputhje me Politikën e Përbashkët të Peshkimit të BE dhe të Strategjisë Kombëtare të Peshkimit me fokus zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të peshkimit dhe akuakulturës, shfrytëzimin e përgjegjshëm të burimeve peshkore dhe kapaciteteve të flotës së peshkimit, përcaktimin e rregullave për menaxhimin dhe bashkëmenaxhimin e sektorit të peshkimit dhe të porteve dhe qendrave të peshkimit, zbatimin e një politike strukturore dhe ngritjen e një sistemi kontrolli dhe inspektimi për peshkimin në det, në tokë dhe në të gjithë zinxhirin e tregut.

Programi buxhetor “Mbështetje për Peshkimin”, për vitin 2025 ka në dispozicion gjithsej 527,287,000 lekë, nga të cilat:

- Shpenzime korrente 215,864 mijë lekë, dhe
- Shpenzime kapitale 311,423 mijë lekë

Gjatë periudhës raportuese janë kryer një sërë aktiviteteve në drejtim të plotësimit të objektivave të programit, ndër të cilat rendisim:

- Menaxhimi i vazhdueshëm i porteve Shëngjin, Vlorë, Sarandë e Durrës dhe të tre ekonomive Zvezdë, Lin e Butrint.
- Janë kryer 30 kontrolle e inspektime në zbatim të Ligjit të Peshkimit Nr. 64/2012 dhe të Rregulloreve përkatëse për një shfrytëzim sa më të mirë të burimeve peshkore.

Produktet e përfituara për periudhën e 4 mujorit të I të vitit 2025, janë realizuar si më poshtë:

Produkti 90503AA: Infrastruktura portuale e mirëmanaxhuar.

Plani për vitin 2025: 184,364 mijë lekë	Fakti për 4 mujin e I: 48,436 mijë lekë
---	---

Buxheti për këtë produkt Menaxhimi i porteve është një proces në vazhdimësi për të katër portet e peshkimit: në Durrës, Shëngjin, Vlorë dhe Sarandë dhe të tre ekonomive Zvezdë, Lin e Butrint.

Produkti 90503AB: Kontrollat e inspektoratit të peshkimit në subjektet e peshkimit:

Plani për vitin 2025: 17,000 mijë lekë	Fakti për 4 mujin e I: 22,2 mijë lekë
--	---------------------------------------

Gjatë periudhës së raportimit janë kryer 30 kontrolle dhe inspektime të vazhdueshme në lidhje me zbatimin e kushteve të vendosura në lejet për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit si në det dhe në ujërat e brendshme dhe akuakulturës. Prioritet ka qenë inspektimi në vijën bregdetare për parandalimin e evidentimin e gjuetisë së paligjshme. Gjithashtu janë kryer

kontrolle e inspektive në det, në ujërat e brendshme, në pikat e tregimit dhe magazinimit të produkteve peshkore, etj.

Produkti 90503AD: Raporte të kryera për një monitorim sa më të saktë të aktiviteteve të lidhur me peshkimin, akuakulturën dhe molusqet.

Plani për vitin 2025: 3.500 mijë lekë	Fakti për 4 mujorin e I: 95,3 mijë lekë
---------------------------------------	---

Produkti 90503AF: Ripopullim me rasate për pasurim të resurseve peshkore

Plani për vitin 2025: 11.000 mijë lekë	Fakti për 4 mujorin e I: 525 mijë lekë
--	--

Ky produkt ka për qëllim ripopullimin me rasate për rritjen e rezervave peshkore. Gjatë 4 mujorit të I, viti 2025, është bërë blerja e bazës material, ushqim rasati, grumbullim veze, etj.

Produkti 19AB801: Mbështetje për zhvillimin e tregjeve dhe prodhimitarisë detare

Plani për vitin 2025: 204.314 mijë lekë	Fakti për 4 mujorin e I: 0 lekë
---	---------------------------------

Produkti 19AB802: Projekti CBC - SA - SKILLS

Plani për vitin 2025 8,600 mijë lekë	Fakti për 4 mujorin e I : 0 lekë
--------------------------------------	----------------------------------

Produkti 21AC709: Implementimi i sistemit ERS

Plani për vitin 2025: 73,824 mijë lekë	Fakti për 4 mujorin e I: 73,824 lekë
--	--------------------------------------

Implementimi i Sistemit të Raportimit Elektronik të të dhënave (ERS) në peshkim është një sistem që regjistron, raporton, përpunon, ruan dhe transmeton të dhënat e peshkimit (zënie, zbarkim dhe transbordim). Regjistrimi dhe raportimi elektronik i të dhënave të peshkimit ka për qëllim të forcojë efektivitetin e operacioneve të monitorimit, kontrollit dhe mbikëqyrjes si në det ashtu edhe në tokë. Për këtë projekt është lidhur kontrata që prej viti 2024, vijon likuidimi financiar deri në vitin 2026.

Produkti 21AC601: Thellimi i grykëderdhjes së kanalit të Butrintit me detin LOTI I

Plani për vitin 2025: 21, 664 mijë lekë	Fakti për 4 mujorin e I: 0 lekë
---	---------------------------------

Thellimi i grykëderdhjes së kanalit të Butrintit me detin LOTI I, parashikon fillimin e punimeve për thellimin e grykëderdhjes së kanalit që lidh lagunën e Butrintit me detin. Thellimi i kanalit do të mundësojë rritjen e fluksit të ujë këmbimit midis lagunës dhe detit. Thellimi i kanalit në Liqenin e Butrintit synojnë përmirësimin e cilësisë së produktit si dhe rritje në sasi dhe vlerë të midhjes të prodhuar në këtë zonë.

7. Programi 05470, “Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës Bujqësore”.

Realizimi i shpenzimeve për 4 mujorin e parë të vitit 2025 për këtë program, që përfaqëson **0.24%** të buxhetit faktik të kësaj ministrie, sipas zërave kryesorë, krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

- | | |
|-----------------------|-----|
| • Shpenzimet korrente | 0 % |
| • Shpenzimet kapitale | 0 % |
| • Gjithsej | |

Në kuadër të programit “Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës Bujqësore” i cili synon krijimin e Sistemit të Informacionit për Tokën (LIS) në rreth 15,500 ha tokë bujqësore në njësitë administrative Melan dhe Kastriot të qarkut Dibër, Stëblevë të qarkut Elbasan, Bushat të qarkut Shkodër dhe Rrogozhinë të qarkut Tiranë, si 4-mujor janë realizuar aktivitetet e mëposhtme:

- Përgatitja e planit të punës për realizimin e objektivave për vitin 2025 si dhe detajimi i buxhetit;
- Përgatitja e planit dinamik për aktivitetet dhe objektivat e planifikuar;
- Gjeoreferencimi i hartave topografike ushtarake me shkallë dhe 1:25 000;
- Përcaktimi i volumeve të punës të cilat do të kryhen në terren (sondimet e tokës) për njësitë administrative Melan dhe Kastriot të bashkisë Dibër;
- Rikonicioni i zonave në njësitë administrative Melan të bashkisë Dibër;
- Sigurimi i regjistrave manual të tokës bujqësore për dixhitalizim në katër njësi administrative;
- Përgatitja e specifikimeve teknike për objektin e prokurimit "Blerje paisje kompjuterike&laboratorike për sistemin GIS";
- Azhurnimi i të dhënave për tokën dhe software.

Shënim: Përsa i përket shpenzimeve deri tani nuk janë kryer sepse miratimi i projekteve problemorë ka ardhur në datën 13.05.2025 dhe ligji i prokurimeve publike nuk lejon copëtimin ose prokurimin e të njëjtit objekt disa herë gjatë vitit.

❖ Situata e Detyrimeve të Prapambetura

Drejtoria e Buxhetimit dhe Menaxhimit Financiar ka monitoruar detyrimet e prapambetura të institucioneve zbatuese dhe në datën 30 Prill 2025, për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural rezulton që Institucionet tona të varësisë, kanë vetdeklaruar në Degët e Thesarit, detyrime të prapambetura si më poshtë:

- Për Aparatin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për shumën 7,309,400 lekë, si detyrim të prapambetur për ngritjen e sistemit të ERS-së. Lidhur me këtë detyrim, gjatë detajimit të buxhetit për vitin 2025, fondi është parashikuar për likuidim në vitin 2026.
- Drejtorinë e Ujitjes dhe Kullimit Fier, për shumën 156,915,075 lekë, si detyrim të prapambetur për punimet e kryera në investimet me objekt:
 - Rehabilitimi i Kanalit Kryesor Ujitës Llakatund, Vlorë;
 - Shkarje në kanalin ujitës VMK2 (pjesë e skemës Kurjan-Strum);
 - Mbrojtje nga Lumi Kalasë (Kaskada e Shelegarit);
 - Riparim i argjinatures Mbrojtëse të Kolektorit K17 Butrint;
 - Mbrojtje nga Lumi Kalasë (Kaskada e Vanës);
 - Riparimi i Argjinatures së Majtë të Lumit Seman;
 - Mur mbajtës në Kolektorin Roskovec-Hoxhare, Fier.
- Për Drejtorinë e Ujitjes dhe Kullimit Korçë, për shumën 51,046,621 lekë, si detyrim të prapambetur për punimet e kryera në investimet me objekt:
 - “Mbrojtje nga gërryerjet dhe përmytja nga lumi Osum, në Starovë – Rëmanicë”
 - “Rehabilitim vepra e marrjes + skema ujitëse, Naum Panxhi”

❖ **Produktet dhe politikat qjinore**

Në vijimësi nga vitet e kaluara, është mbajtur parasysh zbatimi i VKM-së nr. 465, datë 18.7.2012, “*Për integrimin gjinor në Programin Buxhetor Afatmesëm*”, duke përcaktuar në objektiva si dhe në tregues performance, produktet që i përkasin çështjeve të barazisë gjinore, ku në programin buxhetor “*Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor*”, Qëndrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, dhe në programin e dytë “*Zhvillimi Rural*”.

- Për programin 04250; Për 4 mujorin e parë të vitit 2025, referuar indikatorit “Numër përfituesish burra dhe gra nga IPARD” dhe për indikatorin “Numër përfituesish burra dhe gra nga Skemat Kombëtare”, duke qenë se jemi ende në fazën e aplikimeve, nuk mund të specifikohet ky tregues. Gjithashtu për “**Skema e investime me grant në ferma**” janë lidhur 251 kontrata, nga të cilat 38 janë gra dhe 213 burra. Për periudhën raportuese janë disbursuar 5,540,868 lekë për 7 përfitues, nga të cilët 1 përfitues është grua.

- Për programin 04860; gjatë 4 mujorit të vitit 2025, nga strukturat e Shërbimit Këshillimor janë kontaktuan dhe kanë marrë informacion gjithsej rreth 41,667 fermerë dhe agrobiznese (nga të cilët 2,693 janë gra fermere) nga 100,000 fermerë dhe agrobiznese të synuara.

Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore në bashkëpunim me Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, për vitin 2025 kanë planifikuar për të realizuar 5 ditë trajnimi të dedikuara për 520 gra fermere, me synim zbutjen e parabarazisë dhe integrimin gjinor. Këto trajnime do të realizohen kryesisht gjatë 6 mujorit të II-të vitit.

❖ **Komente mbi sistemin AFMIS**

Sa i përket sistemit AFMIS, për periudhën e katërmujorit të parë, janë hasur disa probleme lidhur me funksionimin e sistemit. Aktualisht, viti 2025 nuk shfaqet në sistem për këtë periudhë monitorimi, çka po pengon punën e ekipeve të menaxhimit të programeve në përditësimin e të dhënave përkatëse.

Sa i përket funksionimit të sistemit AFMIS gjatë periudhës së katërmujorit të parë, janë hasur vështirësi të konsiderueshme që kanë ndikuar drejtpërdrejt në procesin e monitorimit. Aktualisht, sistemi nuk shfaq vitin aktual dhe si rrjedhojë krijoi janë krijuar pengesa serioze për ekipet e menaxhimit të programeve në realizimin dhe përditësimin e informacionit të nevojshëm. Kjo situatë ka vështirësuar ndjeshëm vijimësinë normale të punës.

Gjithashtu, duke qenë se anekset shoqëruese të monitorimit janë plotësuar manualisht, ekziston mundësia që, pavarësisht verifikimeve të kryera, të ketë ndonjë pasaktësi në raportim.

Përsa i përket gjenerimit nga programi AFMIS të tabelave mbi realizimin e treguesve të Programit “Menaxhimi i Infrastrukturës së Kullimit dhe Ujitjes”, sjellim në vëmendja sa më poshtë:

Sasitë e produkteve (output) me vlerë më të vogël se 1, për vitin 2024 nuk janë ruajtur në vlerën përkatëse, gjë për të cilën jemi detyruar, që për sasitë e produkteve që maten më km (kilometër argjinature), për vlerën më të vogël se 1, të vendosim apriori vlerën 1.

Ndërsa për vitin 2025 produktet (sasitë), në tabelat përkatëse, janë hedhur manualisht, kjo, për faktin se sietmi AFMIS nuk i ruan këto vlera.

Planifikimi dhe Realizimi i të ardhurave

Për vitin 2025, në total për MBZHR-në janë parashikuar në PBA 251,762,000 lekë. Për 4 mujorin e parë të këtij viti, janë realizuar të ardhura në vlerën 55,314,387 lekë. Janë përdorur në fakt 3,551,035 lekë nga 49,029,000 lekë të planifikuara në buxhet. Nëpërmjet të

ardhurave dytësore institucionet zbatuese të MBZHR-së kanë derdhur në buxhetin e shtetit 47,180,339 lekë.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,